



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/ 2021, për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Votim jashtë Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 13.09.2021, nxjerr këtë:

## V E N D I M

**Për Miratimin e Rekomandimit nga Verifikimi i Aplikacioneve për Regjistrim për Votim Jashtë Kosovës në katër komunat: Dragash, Suharekë, Junik dhe Mamushë,**

- I. Miratohet Rekomandimi i Këshillit të Operacioneve Zgjedhore nga verifikimi i aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës në katër komunat: Dragash, Suharekë, Junik dhe Mamushë.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Rekomandimi si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.09.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Data	09.09.2021	Ref. Nr.
Për	Këshillin e Operacioneve Zgjedhore	
Nga	Besnik Buzhala, U.D. i Zëvendësit të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së	
Përmes	Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së	
Lënda	Rekomandim nga verifikimi i aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës në katër komunat: Dragash, Suharekë, Junik dhe Mamushë	

Pas shqyrtimit të raportit përfundimtar për periudhën e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës, ashtu sic edhe është kërkuar, Sekretariati i KQZ-së ka bërë verifikimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës për katër (4) komunat, si më poshtë:

- Dragash,
- Suharekë,
- Junik, dhe
- Mamushë.

Verifikimi i aplikacioneve për regjistrim përmes thirrjeve telefonike është bërë në masën 2% nga numri total i aplikacioneve të aprovuara për komunat e sipër përmendura, duke marrë mostrën sipas rastësisë.

Kështu, numri i aplikacioneve që janë verifikuar, është bërë si në vijim:

Nr.	Komunat	Numri i aplikacioneve të aprovuara	Numri i aplikacioneve të verifikuara (%)
1	Dragash	1,094	22 aplikacione (2%)
2	Suharekë	1,859	38 aplikacione (2%)
3	Junik	1,051	22 aplikacione (2%)
4	Mamushë	245	13 aplikacione (2%)

## **1. Koha e thirrjeve telefonike**

Me qëllim të verifikimit të aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës, Sekretariati i KQZ-së përmes thirrjeve telefonike ka bërë verifikimin e nëntëdhjetë (95) aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës për katër komunat (Dragash, Suharekë, Junik dhe Mamushë).

Thirrjet telefonike janë realizuar në datat, si në vijim:

- 24 gusht 2021,
- 26 gusht 2021,
- 30 gusht 2021,
- 7 shtator 2021,
- 8 shtator 2021, dhe
- 9 shtator 2021.

Të gjitha thirrjet dhe tentimet për thirrje telefonike, në datat e më sipërme janë bërë prej orës 17:00.

## **2. Rezultatet pas verifikimit të aplikacioneve nga thirrjet telefonike**

### ***Komuna e Dragashit (22 aplikacione të verifikuara përmes thirrjeve telefonike)***

- a) 14 aplikues konfirmojnë të dhënat se kanë aplikuar personalisht (63.63%).
- b) 3 persona që janë kontaktuar, konfirmojnë se nuk janë personat që kanë aplikuar për regjistrim.
- c) 5 aplikues nuk e hapin telefonin ose paraqitet mesazhi automatik "Telekomi i Kosovës".

### ***Komuna e Suharekës (38 aplikacione të verifikuara përmes thirrjeve telefonike)***

- a) 25 aplikues konfirmojnë të dhënat se kanë aplikuar personalisht (65.78%).
- b) 5 persona që janë kontaktuar, konfirmojnë se nuk janë personat që kanë aplikuar për regjistrim.
- c) 11 aplikues nuk e hapin telefonin ose paraqitet mesazhi automatik "Telekomi i Kosovës".

### ***Komuna e Junikut (22 aplikacione të verifikuara përmes thirrjeve telefonike)***

- a) 12 aplikues konfirmojnë të dhënat se kanë aplikuar personalisht (54.54%).
- b) 6 persona që janë kontaktuar, konfirmojnë se nuk janë personat që kanë aplikuar për regjistrim.
- c) 4 aplikues nuk e hapin telefonin ose paraqitet mesazhi automatik "Telekomi i Kosovës".

### ***Komuna e Mamushës (13 aplikacione të verifikuara përmes thirrjeve telefonike)***

- a) 2 aplikues konfirmojnë të dhënat se kanë aplikuar personalisht (15.38%).
- b) 6 persona që janë kontaktuar, konfirmojnë se nuk janë personat që kanë aplikuar për regjistrim.
- c) 5 aplikues nuk e hapin telefonin ose paraqitet mesazhi automatik "Telekomi i Kosovës".

Për shkak të përqindjes së vogël të konfirmimit përmes telefonit, Këshilli për Operacione Zgjedhore në mbledhjen e mbajtur me 7 shtator ka urdhëruar Sekretariatit që të bëjë verifikimin e aplikacioneve totale që i përkasin komunës së Mamushës.

Verifikimi total për Komunën e Mamushës është bërë më datat 8 dhe 9 shtator 2021, me këto rezultate:

Nga 223 aplikacione të kontaktuar/ verifikuara:

- a) 40 persona kanë konfirmuar të dhënat sikurse në aplikacion (kanë aplikuar personalisht) 17.93%,
- b) 48 persona kanë deklaruar se nuk kanë aplikuar personalisht,
- c) 135 persona nuk e kanë hapur telefonin (me dy tentime: 8 dhe 9 shtator).

### **REKOMANDIM:**

1. Sekretariati i KQZ-së, rekomandon largimin nga lista e votuesve jashtë Kosovës për 68 persona që kanë deklaruar se nuk kanë aplikuar personalisht:
  - a) 3 persona – Komuna e Dragashit,
  - b) 5 persona – Komuna e Suharekës,
  - c) 6 persona – Komuna e Junikut, dhe
  - d) 54 persona – Komuna e Mamushës.